

CORONAVIRUS: LETËR E MINISTRIT GJENERAL

TË GJITHË VËLLEZËRVE TË URDHËRIT
Zoti ju dhashtë paqe!

Gjatë këtyre tre muajve të fundit apo pak më shumë prej zbulimit të Coronavirus-it të ri, kemi vërejtur përhapjen e tij progresive nga një rajon specifik i Kinës në më shumë se 115 vende. Praktikisht e gjithë bashkësia njerëzore gjendet e angazhuar në një betejë të rëndësishme për t'u përpjekur që të frenojë një përhapje më të madhe, që të kujdeset për ata që janë goditur (më shumë se 126.000 raste), dhe që të qajë personat e dashur që kanë vdekur (më se 4.500). Rënia ekonomike për kombet, për personat dhe në mënyrë të veçantë për të varfrit, pa dyshim që do të jetë shkatërrimtare.

Në stadtet e para të kësaj pandemie, ndoshta e konsideronim veten të mbrojtur, imunë, të largët dhe ndoshta edhe pak mospërfillës ndaj virusit dhe ndikimit të tij. Megjithatë, meqenëse virusi është duke vazhduar të përhapet në mënyrë të pandalshme, gjendemi në epiqendrën e një krize. Ka shumë aspekte shkencore të virusit që ende nuk janë kuptuar plotësisht. Ai nuk respekton as limitet as kufijtë: fizikë, shoqërorë, psikologjikë, fetarë apo kulturorë. Aftësia e tij strategjike për të kaluar nga një bartës në një tjetër e bën veçanërisht agresiv. Përgjigjet e ideuara dhe të zbatuara prej qeverive të ndryshme për të ndaluar përhapjen e tij kërkojnë nga ana e shumë prej nesh një shtrëngesë të tillë të ushtrimit të lirisë sonë personale të papërdoruar kurrë më parë. Megjithatë, këto masa janë të nevojshme për të parandaluar një përparim të mëtejshëm të virusit. Një lutje e veçantë shkon për ata që janë duke shërbyer në linjë të parë, për personelin mjekësor, për ata që janë të angazhuar në kërkim për të gjetur një vaksinë, dhe për qeveritë që janë duke u përpjekur për të gjetur përgjigje efikase në garantimin e sigurisë dhe të shëndetit të popullit të tyre.

Po ju shkruaj në këtë moment me qëllimin që të përpiqem t'ju ndihmoj të lehtësoni frikat e ankthet. Për ata prej nesh që janë duke jetuar në vende shumë të goditura nga virusi, dëshiroj t'ju jap zemër për të qëndruar të fortë në fe. Për ata që jetojnë në vende me një numër më të vogël të infektuarish, jini gjithmonë të kujdesshëm në gjithçka.

Në këtë kohë të veçantë liturgjike të Kreshmëve, besimtarët e krishterë janë të ftuar të shoqërojnë Jezusin, duke kujtuar sfidat e mëdha dhe momentet e krizës të përballuara nga ai, duke kujtuar edhe vdekjen e tij në kryq, si fli e dashurisë së pastër. Por as vuajtja as vdekja nuk e kanë pasur fjalën e fundit mbi jetën e tij, kështu nuk do ta kenë as mbi jetën tonë. Shpresa që na vjen prej ringjalljes dhe prej gjesteve të përditshme të drejtësisë, mëshirës e dashurisë, duhet të na motivojë për të shikuar përtej çdo frike apo ankthi dhe për të ndier praninë e Jezusit që vazhdon të thotë për ne të njëjtat fjalë që u tha miqve dhe nxënësve të tij të dashur: “Mos kini frikë! Unë jam me ju deri në të sosur të botës!”.

Në mes të kësaj epidemie globale, të mos i harrojmë shumë milionë persona në botë që janë duke vuajtur prej krizash të tjera. Zemrat tona janë të drejtuara në mënyrë krejt të veçantë nga popullsitë e Sirisë, Republikës Demokratike të Kongos, Venezuelës, Mindanaos, Republikave të Sudanit dhe Sudanit të Jugut, Palestinës, Libanit dhe nga vëllezërit e motrat që jetojnë në pjesë të tjera të botës ku dinjiteti njerëzor, të drejtat themelore dhe mbijetesa fizike minimale janë të kërcënuara. Le ta pranojmë ftesën për të shikuar përtej çdo ndarjeje apo frike, për të kërkuar rrugë të reja dialogu të njëmendtë, bashkëpunimi dhe nxitjeje të mirëqenies së të gjithë njerëzimit, në mënyrë të veçantë të të varfërve dhe të të mënjanuarve. Gjithashtu, le ta thellojmë angazhimin tonë për ta dashur dhe për t'u kujdesur për mjedisin, shtëpinë tonë të përbashkët.

Zoti e bekoftë secilin prej jush, dhe le të lejojmë që forca e sigurive tona, angazhimi ynë për një mënyrë jete ungjillore të frymëzuar nga shën Françesku të na lejojnë të jemi dëshmitarë besnikë të fuqisë së dashurisë dhe të shpresës që feja jonë na jep ne dhe gjithçkaje që ekziston.

Romë, 12 mars 2020

Vëllazërisht i juaji në Krishtin dhe shën Françeskun,

Fra Michael A. Perry, OFM
Ministër Gjeneral dhe Shërbëtor

LAJME TË TJERA



CNA: Françeskanët në Siri si janë duke i ndihmuar fëmijët që të shërohen nga trauma e luftës

Nga artikulli i botuar më 7 mars 2020 nga Catholic News Agency: Franciscan Education Channel

Si meshtar misionar në luftë në Alepo, atë Firas Lufti ka qenë dëshmitar i traumës së pësuar nga një brezni fëmijësh sirianë që e kanë kaluar gjithë jetën në pasigurinë dhe në tragjedinë e luftës... Lufti ka themeluar programin pas-traumatik të trajtimit luftarak Franciscan Care Center (Qendra e asistencës terapeutike françeskane) në Alepo në vitin 2017. Që atëherë, stafi i tij i psikologëve klinikë, vullnetarë dhe asistentë socialë, kanë ndjekur 1.500 fëmijë sirianë të moshës mes 6 dhe 17 vjeç.

Përveç trajtimit psikologjik, qendra ofron terapi artistike dhe veprimtari zbatimëse me pikturë, skulpturë, muzikë, teatër, vallëzim, basketboll dhe not. Gjithashtu, propozon një kurs formimi për prindër të përqendruar në metodat e përkujdesjes dhe mbështetjes sa më mirë të shëndetit mendor të fëmijëve të tyre gjatë trajtimit.

Prej fillimit të luftës civile siriane, mars 2011, janë vrarë rreth 500.000 persona. Sipas Kombeve të Bashkuara, në vitin e tetë të konfliktit, 5,6 milionë refugjatë kanë ikur nga vendi dhe 6,1 milionë të tjerë janë shpërngulur krejtësisht.

Lexo krejt historinë në CNA:
www.catholicnewsagency.com



Përballoje epideminë me Shën Françeskun: një seri videoklipesh

OFM Hong Kong Education Office është duke prodhuar videoklipe të shkurtra që tregojnë mënyra të ndryshme për t'iu përgjigjur problemeve të shkaktuara nga Coronavirus. Dy klipet e fundit kanë temat "Si ta dëftojmë dashurinë gjatë epidemisë?" dhe "Si ta kërkojmë TË VËRTETËN gjatë EPIDEMISË?".

Videot e fundit janë në anglisht ndërsa ato të mëparshmet janë në gjuhën kineze me nëntituj në anglisht. I gjen në YouTube:

Franciscan Education Channel

Komunikatë e Patriarkëve dhe e krerëve të Kishave të Jerusalemit mbi pandeminë COVID-19:

Në këtë moment të vështirë dhe angazhues, planeti ynë Tokë vuan për shkak të pandemisë COVID-19 që ka goditur shumë persona dhe ka marrë mijëra jetë. Për ta përballuar këtë pandemi që kërcënon shëndetin dhe jetën, është thelbësore që njerëzit tanë dhe bashkësitë tona t'u përmbahen dispozitave dhe udhëzimeve të autoriteteve civile të vendeve ku jetojmë.

Në të njëjtën kohë, ne, Patriarkët dhe krerët e Kishave të Jerusalemit, i kërkojmë Hyjit të Gjithëpushtetshëm që ta shikojë situatën tonë dhe të dëftohet dashamirës ndaj botës sonë që vuan. Jemi të gjithë të thirrur ta jetojmë këtë kohë duke vazhduar të kemi besim në Atin tonë qiellor që kujdeset për të gjitha krijesat e veta. Prandaj është mirë që të intensifikohen lutja personale, agjërimi e lëmosha dhe të ecet në dritën e dashurisë së Hyjit.

Burimi: www.lpj.org

Kujdesi për të sëmurët në jetën françeskane gjatë viteve

Françesku dhe Kjara e kanë bërë kujdesin për të sëmurët pjesë të rëndësishme të jetës së tyre, si në mënyrë individuale ashtu edhe si drejtues të bashkësive përkatëse.

Mes mrekullive të shumta të atribuara Françeskut, ndërsa ishte në jetë dhe pas vdekjes së tij, është vërtetuar një pafundësi shërimesh nga sëmundje e plagë të ndryshme, të kataloguara nga Tommaso da Celano, në veprën e tij Traktat mbi mrekullitë e shën Françeskut. Procesi i kanonizimit të shenjtës Kjarë përfshin dëshminë e shumë personave sëmundjet e të cilëve u kuruan prej lutjeve të shenjtës Kjarë në kuvendin e Shën Damianit.

Në shekujt pas vdekjes së dy themeluesve, ndërsa familja françeskane u përhap në Evropë, në Azi, në Amerikë e në Afrikë, shumë rregulltarë dhe laikë françeskanë, burra e gra, vazhduan forma të ndryshme të shërbimit ndaj të sëmurve, në veçanti ndaj atyre të varfër.


Spitale të shumta françeskane mbanin emrin e Shën Didakut (Shën Diego de Alcalá), frat laik spanjoll i oservancës. Sikurse mijëra bashkëvëllezër të tij, udhëtoi drejt Romës për Vitin Jubilar dhe kanonizimin e Bernardinit nga Siena në maj 1450. Pak më vonë, një valë murtaje shpërtheu mes turmave të shtegtarëve dhe, ndërsa shumë ikën prej qytetit, ky frat i guximshëm, pa një formim mjekësor të specializuar, qëndroi për të kuruar vëllezërit e vet që ishin sëmurrur, duke organizuar shpërndarjen e ushqimeve shtegtarëve të shumtë të bllokuar në qytetin i cili kishte rënë në kushte të frikshme. Sjellja e tij është një shembull i rasteve të shumta heroike pak të njohura që kanë ndodhur gjatë epidemive.

Nga fundi i shek. XVIII deri në shek. XIX bashkësitë e reja françeskane, në veçanti ato të rregulltarëve, i kanë përqendruar përpjekjet e tyre në format e asistencës shëndetësore për popullsitë e pazhvilluara.

Shembuj historikë mbi domethënien e asistencës ndaj të sëmurve brenda formës së jetës françeskane gjatë viteve trajtohen në Archivum Franciscanum Historicum - N. 1-2, Anno 2014.

Për të thelluar:
www.libreriadelsanto.it | [Summaria](#)

SHËNJUES FRANÇESKAN




GIUSEPPE BUFFON OFM, PAPA FRANCESCO, E dashur Amazonë: Teksti i plotë i Nxitjes passinodale dhe i Dokumentit Përfundimtar të Sinodit të veçantë për Amazonën,

Edizioni Terra Santa, Milano 2020, fq. 176

Querida Amazonia, E dashur Amazonë, është – për nga përmbajtja, forma e thjeshtë dhe gjuha e qartë – një mesazh i drejtuar të gjithë personave vullnetmirë në të cilin papa Françesku ka dashur të përmbledhë jehonat që Sinodi i veçantë për rajonin Pan-Amazonik ka sjellë në zemrën e tij si njeri dhe si Papë.

Në Querida Amazonia hapet një horizont i vërtetë edukativ e baritor në drejtim të së ardhmes së botës dhe të Kishës, një projekt që nuk do të mund të bëjë pa pranuar instancat që përmbahen në Dokumentin Përfundimtar të Sinodit që Papa fton ta lexojmë, ta përhapim dhe ta meditojmë.

Të dy dokumentet – Nxitja Apostolike dhe Dokumenti Përfundimtar i Sinodit – janë hapur dhe komentuar nga një “udhërrëfyes leximi” i hollësishëm me firmën e teologut italian më me autoritet, ekspert i ekologjisë integrale: Giuseppe Buffon ofm.



THOMAN BRET, Shën Françesku i Asizit. Jeta e një njeriu me të vërtetë të lumtur, Edizioni Porziuncola, S. Maria degli Angeli 2019, fq. 184
Francesku i Asizit ishte i gjatë pak më pak se një metër e gjysmë, nuk ishte veçanërisht i hijshëm, as nuk ishte një intelektual... E megjithatë, njihet edhe si Alter Christus, “Krishti tjetër”.

Një Shenjt universalisht i dashur dhe i njohur. Por a jemi të sigurtë se e dimë kush ishte me të vërtetë ai njeri në thellësitë e tij? Çfarë e çoi nga një qytet i vogël në zemër të Umbrias në lartësitë e shenjtërisë, në nderet e oborrit qiellor? Në biografinë e tij tërheqëse, autori arrin të depërtojë në jetën e brendshme të shën Françeskut, duke zbuluar pasionet e tij më të thella, dashurinë e pashtershme për varfërinë dhe besnikërinë e paepur ndaj thelbit të Ungjillit. Jeta e Shenjtë të Asizit, shpesh e paraqitur si spektakolare dhe e mrekullueshme, në realitet është historia e një shpirti që dëshiron Hyjin dhe që e dallon praninë e Tij në të gjithë krijimin.


YONGHO FRANCIS LEE OFM, Mysticism and Intellect in Medieval Christianity and Buddhism: Ascent and Awakening in Bonaventure and Chinul (Misticizmi dhe Intelekti në Krishterimin Mesjetar dhe në Budizëm: Ngritja dhe Rizgimi tek Bonaventura dhe Chinul), Lexington Books, Lanham 2020, fq. 326

Libri eksploron rrugëtimin e bërë nga dy mësuesit ndikues intelektualë e fetarë të krishterimit dhe të budizmit, Bonaventura (rreth 1217-1274) dhe Chinul (1158-1210), përkatësisht një teolog françeskan dhe një mësues zen korean. Trajtimi vë në dukje përpjekjet e tyre të bëra gjatë gjithë harkut të jetës për të integruar jetën intelektuale dhe atë shpirtërore, në mënyrë që të arrihen caqet fetare të caktuara të traditave përkatëse fetare. Heton edhe në lidhje me tensionin mes modaliteteve të ndryshme në lidhje me argumentin hyjnor apo absolut — pozitiv (katafatik) dhe negativ (apofatik). Të dyja këto modalitete argumentimi janë të lidhura ngushtë me mënyra të ndryshme të kuptimit të imanencës dhe të transhëndencës së hyjnore apo të absolute. Nëpërmjet studimeve të thelluara të Bonaventurës dhe Chinul-it, libri paraqet një dialog origjinal mes krishterimit e budizmit dhe mes Perëndimit e Lindjes.

GIANLUIGI PASQUALE OFMCapp, San Francesco: La risposta alla domanda che nessuno pone, La Fontana di Siloe (Shën Françesku: Përgjigjja ndaj pyetjes që askush nuk e shtron, Burimi i Siloamit), Torino 2019, fq. 336

Francesku i Asizit tërheq nga vetja, si një magnet i fuqishëm, besimtarë, jo besimtarë dhe myslimanë (kjo biografi del pikërisht me rastin e 800-vjetorit të takimit në Damiata mes Varfanjakut të Asizit dhe sulltanit Al-Malik al-Kāmil).

Arsyeja është e thjeshtë: është ai që në histori e ka përfaqësuar më mirë Jezusin. E gjithë madhështia e tij i ka rrënjët në atë moment fillestar të Porciunkolës kur filloi të jetonte sikur Ungjilli të ishte një kod i jetës shoqërore tejet i zbatueshëm. Askush nuk e kishte pyetur veten me të vërtetë nëse Ungjilli ishte tërësisht i zbatueshëm, «në letër». Sekreti i Françeskut, siç dëfton ky libër, gjendet në mishërimin personalisht të kësaj mundësie, duke e realizuar atë: kjo është përgjigjja e tij, faktikisht e vetmja që mund ta bëjë të besueshëm krishterimin.



**GIANLUIGI PASQUALE
SAN FRANCESCO
LA RISPOSTA ALLA DOMANDA
CHE NESSUNO PONE**



NGJARJE



1ER CONGRESO
INTERNACIONAL
LOS FRANCISCANOS
EN BOLIVIA
1ER ANIVERSARIO DEL SÍNODO AMAZÓNICO

KONGRESI I PARË NDËRKOMBËTAR: FRANÇESKANËT NË BOLIVI DHE PËRVJETORI I PARË I SINODIT AMAZONIK

Duke iu përgjigjur propozimeve të bëra nga papa Françesku e nga ipeshkvijetë e Amazonës dhe duke pasur parasysh se shën Françesku është deklaruar Pajtari i Ekologjisë, në kuadër të përgatitjes së 200-vjetorit të veprimit françeskan në Guarayos, në Provincën Françeskane të Shna Ndout në Bolivi, Universiteti Katolik Bolivian "San Pablo", Fakulteti i Teologjisë "San Pablo", Akademia Boliviane e Historisë Kishtare dhe Universiteti Papnor Antonianum, organizojnë Kongresin e Parë mbi "Françeskanët në Bolivi: të drejtat njerëzore të popujve dhe një ekologi integrale".

Objekti i këtij Kongresi është të tregojë veprën misionare të Urdhrit françeskan në Bolivi, një tokë e pasur me larmi etnike e kulturore, ku vepra e françeskanëve është e njohur si pjesë aktive e formimit të Bolivisë si komb. Larg nga një vizion apologjetik, ky kongres vendoset në një hapësirë reflektimi mbi veprën e Urdhrit për veprën e tij ungjillëzuese dhe ndihmesën e tij për afrimin plot respekt ndaj popujve vendas dhe ndaj mjedisit ku gjendet vepra françeskane.

Data: 7-9 tetor 2020

Vendi: Universiteti Katolik Bolivian "San Pablo" – Rajoni Cochabamba dhe Fakulteti i Teologjisë "San Pablo"

Informacione të mëtejshme në: www.ofm.org:
[ENGLISH](#) – [ESPAÑOL](#) – [ITALIANO](#)



LUTJE DREJTUAR MARISË,
SHËNDETIT TË TË SËMURËVE,
E PAPËS FRANÇESKU
PËR TË KËRKUAR MBROJTJEN E SAJ
GJATË PANDEMISË
SË CORONAVIRUS-IT

O Mari,
ti shkëlqen gjithmonë në rrugëtimin tonë
si shenjë e shpëtimit dhe e shpresës.
Ne po të besohemi ty, Shëndetit të të
sëmurëve,
që pranë kryqit je bashkuar
me dhimbjen e Jezusit,
duke e ruajtur të patundur fenë tënde.
Ti, Shpëtimi i popullit romak,
e di se për çfarë kemi nevojë
dhe jemi të sigurtë se do të kujdesesh që,
sikurse në Kanë të Galileës,
të mund të kthehet gëzimi e festa
pas këtij momenti prove.

Na ndihmo, o Nënë e Dashurisë Hyjnore,
që t'i përgjigjemi vullnetit të Atit
dhe të bëjmë atë që do të na thotë Jezusi,
i cili ka marrë mbi vete vuajtjet tona
dhe është ngarkuar me dhimbjet tona që,
nëpërmjet kryqit,
të na çojë në gëzimin e ringjalljes. Amen.

Nën mbrojtjen Tënde kërkojmë strehim,
O Shenjtja Nëna e Hyjit.
Mos i përbuz lutjet e neve
që jemi në sprovë,
dhe na liro prej çdo rreziku,
o Virgjër e lavdishme dhe e bekuar.